

SHPLLJA E VENDEVE TË LIRA TË PUNËS

Tabela .1

Nr	Pozicioni i punës	Struktura e interesuar/ Forca	Vendi ku ndodhet	Lloji i kontratës së punës	Procedura e përzgjedhjes së kandidatëve		Afati i aplikimit
					Me dosje	Fillimi	Mbarimi
1	Manovrator i mjeteve të rënda	Reparti Ushtarak nr. 2002	Plepa, Durrës	Me afat	Me dosje	07.06.2022	21.06.2022

Formulari nr. 1

1.Pozicioni i punës: Manovrator i mjeteve të rënda
2. Kodi i pozicionit: Kodi vendodhjes B-002 , Grupi C , Paragrafi 04 , numër rendor 007 , Specialiteti LT 2151 .
3. Reparti/Institucioni: Reparti Ushtarak nr. 2002, në Forcën Detare
4. Vendi: Plepa, Durrës
5. Paga: VKM Nr. 202 datë 15.03.2017 “Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM nr.717 datë 23.06.2009”, për pagat e punonjësve mbështetës të institucioneve buxhetore dhe të nënpunësve të disa institucioneve buxhetore”, i ndryshuar
6. Lloji i kontratës së punës: Me afatë
7. Data e fillimit të aplikimit: 07.06.2022
8. Data e mbylljes së aplikimit: 21.06.2022
9. Mënyra e aplikimit: Për të aplikuar kandidatët duhet të plotësojnë formularin e aplikimit, të cilin do ta gjejnë në faqen e internetit të Ministrisë së Mbrojtjes në adresën www.mod.gov.al . Formulari pasi plotësohet, së bashku me dokumentacionin përkatës, do t’i dërgohet Komandës së Forcës Detare, brenda afatit të caktuar, në zarf, dorazi ose në rrugë postare në adresën: Komanda e Forcës Detare, Plepa Durrës.

10. Dokumentet e aplikimit:

Aplikantët duhet të paraqesin dokumentet e mëposhtme:

- kërkesën;
- formularin e aplikimit;
- fotokopje të kartës së identitetit;
- diplomën e shkollës së mesme/parauniversitare ose të lartë të noterizuar ose në origjinal;
- fotokopje të patentës;
- dëshmi profesioni nëse;
- certifikatë ose dëshmi të gjuhëve të huaja
- raport mjekësor;
- fotografi me përmasa 4x6, 2 copë;
- dëshmi penaliteti;
- vërtetim nga gjykata;
- vërtetim nga prokuroria;
- librezë pune;
- jetëshkrimin (CV).
- formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në faqen e internetit të MM-së në adresën elektronike www.mod.gov.al. (*linku: Baza ligjore/Akte ligjore/ Integriteti i personave që ushtrojnë funksione publike/formulari i vetdeklarimit*)

11. Kërkesat e përgjithshme të pozicionit të punës:

- a) të ketë shtetësinë shqiptare;
- b) të jetë jo më pak se 18 vjeç;
- c) të gëzojë zotësi të plotë për të vepruar;
- d) të plotësojë kërkesat për llojin dhe nivelin arsimor, si dhe të zotërojë aftësitë profesionale të domosdoshme, për vendin përkatës të punës, sipas kritereve të miratuara;
- ç) të jetë i aftë për punë nga ana shëndetësore;
- e) të mos jetë të dënuar me burg me vendim gjykate të formës së prerë për kryerje të një krimi;
- dh) të mos jetë marrë masa disiplinore me largim nga puna, brenda 1 viti nga data e aplikimit.

a. Kërkesat specifike të pozicionit të punës:

- b. Grada/Titulli: Civil
- c. Arsimi : I mesëm i përgjithshëm ose profesional
- d. Kualifikimi: Dëshmi leje drejtimi automjeti klasi “D”/MA.
- e. Kurse dhe dëshmi kualifikimi në fushen që mbulon
- f. Trajnimi: Përputhje e edukimit me funksionin organik
- g. Eksperiencia në Punë: Të ketë eksperiencë të mëparshme në fushën që mbulon.
- h. Gjuha e huaj: Nuk aplikohet

i. Kërkesa të tjera specifike:

j. Niveli i certifikatës së sigurisë: Nuk aplikohet

12. Përshkrimi i punës:

- Drejtues mjeti (Manovrator i mjeteve të rënda)
- Ai varet direkt nga eprori i tij dhe përgjigjet te Komandanti i Kompanisë për realizimin e detyrave

Detyrat kryesore:

- Te njohi ne menyre te persosur perdorimin e mjetit, te zoteroje perdorimin e tij ne te gjitha kushtet e motit dhe te terenit, naten dhe me shikim te kufizuar.
- Te mbaje mjetin ne gatishmeri te perhereshme teknike duke zbatuar te gjitha rregullat per ruajtjen dhe mirembajtjen e tij.
- Te jete I pajisur me te gjitha dokumentet e nevojshme per perdorimin e mjetit dhe te mos ia japi ne perdorim ate tjeterkujt pa urdher te komandes dhe pa dokument dorezimi te rregullt.
- Njohja e karakteristikave teknike, parimi i veprimit dhe paisjeve te brendshme, traktorë , buldozere te klasave te ndryshme.
- Njohja e transmetimeve te paisjes , menytrat e tyre te punes.
- Njohja e bazave te mbrojtjes se punes, siguria e teknologjise se autotraktoreve – buldozere.
- Te mos perdori mjetin kur atij nuk I eshte bere kontrolli teknik para daljes nga parku, sherbimi teknik javor, si dhe sherbimet teknike te radhes.
- Te mos perdori me tej mjetin, kur tek ai ndodhin prishje dhe mungesa ne kompletim qe pengojne punen normale te tij.
- Te mbaje mjetin paster ne venparkim dhe ne gatishmeri te perhereshme.
- Te dije dhe te zbatoje rregullat dhe normat e transportimit te njerezve, te armatimit, dhe te materialeve te tjera dhe te rrisi vazhdimisht ndjenjen e pergjegjesise, vecanerisht per jeten e njerezve.
- Te dije normat e harxhimit te karburant- lyresuesve, te gomave dhe te materialeve te tjera teknike dhe te marrin te gjitha masat per zbatimin dhe permiresimine tyre.
- Te dije afatet, volumin e punes ne kontrollet dhe sherbimet teknike, te kerkoje qe ato te zbatohen dhe te kryej vete te gjitha punimet qe I takojne ne keto sherbime.
- Te mos perdori mjetin pa urdher te komandes dhe pa dokunetet perkatese.
- Te mos perdori per here te pare mjet te ri pa bere nje pergatitje per tu njohur me vecorite e tij
- Të zbatoje me saktesi e ne kohen e duhur detyrat e ngarkuara, te punoje per ngritje tekniko- profesionale.

13. Procedura e përzgjedhjes së kandidatëve:

Përzgjedhja e kandidatëve do të bëhet nga një **komision vlerësimi** i përbërë nga 3 (tre) veta.
Procedura e përzgjedhjes së kandidatëve përfshin:

- përzgjedhjen paraprake;
- vlerësimin e dokumenteve të kandidatëve, që konsiston në vlerësimin e arsimimit, të

eksperiencës e të trajnimeve, të lidhura me fushën përkatëse;

Përzgjedhja paraprake e kandidatëve do të realizohet nga Njësia e personelit të strukturës që është e interesuar për rekrutimin, mbi bazën e dokumentacionit të paraqitur nga kandidatët. Njësia e personelit verifikon dokumentacionin e aplikantëve, nëse ai është i plotë dhe i saktë, si dhe plotësimin e kërkesave të pozicionit të punës nga ana e tyre dhe përcaktonë kandidatët që plotësojnë kërkesat e pozicionit. Vetëm kandidatët që plotëojnë kërkesat e pozicionit do të njoftohen për vazhdimin e mëtejshëm të konkurrimit.

Konkurimi me kandidatët që plotësonë kërkesat e pozicionit të punës përfshin:

- vlerësimin e dokumenteve të kandidatëve (vlerësimin e arsimimit/kualifikimit, vlerësimin e trajnimit dhe vlerësimin e eksperiencës të lidhura me fushën përkatëse;

Vlerësimi i tyre do të bëhet nga komisioni përkatës.

Totali i pikëve të vlerësimit të kandidatëve është 100 (njëqind), të cilat ndahen:

- a. 40 pikë, për vlerësimin e dokumenteve të kandidatëve;
- b. 60 pikë, për intervistën e strukturuar me gojë.

Vlerësimi i dokumenteve të kandidatëve përfshin:

- a. vlerësimin e jetëshkrimit (CV);
- b. vlerësimin e kualifikimeve akademike, profesionale dhe teknike;
- c. vlerësimin e trajnimeve;
- d. vlerësimin e eksperiencave të ngjashme të punës;

Pikët totale të vlerësimit të dokumenteve ndahen, si më poshtë:

- a. jetëshkrimi, 5 pikë;
- b. arsimimi/kualifikimi, 15 pikë;
- c. trajnimi, 5 pikë;
- d. eksperiencia/përvoja në punë, 15 pikë.

Në mbyllje të procesit të vlerësimit, tre kandidatët që kanë marrë më shumë pikë i paraqiten autoriteteve vendimarrëse për miratimin e kandidatit më të përshtatshëm për mbulimin e pozicionit të shpallur.

Me emërimin në pozicionin e punës do të lidhet kontrata individuale e punës.